Agjencia për Zbatimin e Gjuhës

INFORMACIONE MBI TË DREJTAT GJUHËSORE TË QYTETARËVE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

Shkup, 2019

PËRMBAJTJA:

HYRJE.....6-7
LIRIA E SHPREHJES NË GJUHËN TIME ËSHTË E DREJTA IME 7-8
ÇFARË DUHET TË DINË QYTETARËT E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT 8-9
PSE DHE SI U KRIJUA AGJENCIA PËR ZBATIMIN E GJUHËS.....9-11
MISIONI I AGJENCISË.....11-12
ROLI DHE FUSHËVEPRIMI I AGJENCISË 12-13
TË DREJTAT THEMELORE GJUHËSORE NË MAQEDONINË E VERIUT.....13-15
SI DUHET TË JETË NË PRAKTIKË ZBATIMI I GJUHËVE.....15-17
MOHIMI I NJËRËS NGA DY GJUHËT ZYRTARE ËSHTË I NDALUAR.....17-18
ANKESAT PËR DISKRIMINIM NË BAZA GJUHËSORE MUND TË PARASHTROHEN.....18-19
LIGJ PËR PËRDORIMIN E GJUHËVE 19-20
LIGJI I INSPEKTORATIT MBI PËRDORIMIN E GJUHËVE.....40-62

HYRJE

Kemi kënaqësinë t'ju prezantojmë broshurën që shërben për informimin e qytetarëve lidhur me zbatimin e Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve, të parën e këtij lloji, me qëllim që të sjellë në një vend legjislacionin, politikat dhe rolin e strukturave institucionale të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në mënyrë që procesi i respektimit të së drejtës për përdorimin e gjuhëve, si një e drejtë themelore e njeriut, të menaxhohet në mënyrë efektive dhe të përgjegjshme, që u përgjigjet nevojave të qytetarëve. Kjo do të kontribuojë, para së gjithash, në një paraqitje më të mirë të institucioneve, për imazhin e tyre të përgjithshëm më të mirë, për një nivel më të lartë të sundimit të ligjit dhe për integrim më të shpejtë në strukturat euroatlantike. Do të doja t'i falënderoj të gjithë ata që kanë dhënë kontributin e tyre të çmuar në hartimin e kësaj broshure.

Në vitet që kemi lënë pas, institucionet janë angazhuar në mënyrë të vazhdueshme për të krijuar bazën e mjaftueshme ligjore për përdorimin e gjuhëve, si në nivelin qendror, ashtu edhe në atë lokal. Tashmë Republika e Maqedonisë së Veriut ka një legjislacion më të avancuar, i cili rregullon përdorimin e gjuhëve, por që gjatë zbatimit në praktikë shfaqen vështirësi, mangësi, probleme dhe sfida.

Kjo broshurë nuk ndryshon ligjin, por bën një shpjegim të shkurtër, praktik dhe ilustrues. Prandaj, u rekomandojmë të gjithë qytetarëve, përfaqësuesve të institucioneve, krijuesve dhe praktikuesve të politikave, përkatësisht nëpunësve administrativ, ta përdorin këtë broshurë, e cila do të shërbejë si një mjet që e lehtëson qasjen ndaj informacioneve për sa u përket detyrimeve institucionale ndaj të drejtave të qytetarëve për zbatimin e Ligjit të Gjuhëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut.[1]

Prof. dr. Ylber Sela
Drejtori i Agjencisë për Zbatimin e Gjuhës

[1] Ligj për Përdorimin e Gjuhëve (Neni 1). Në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe në marrëdhëniet e saj ndërkombëtare gjuhë zyrtare është gjuha maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik; Gjuhë tjetër që e flasin së paku 20% e qytetarëve (gjuha shqipe), gjithashtu është gjuhë zyrtare dhe alfabeti i saj, në pajtim me këtë ligj.

LIRIA E SHPREHJES NË GJUHËN TIME ËSHTË E DREJTA IME

Liria e shprehjes në gjuhën time paraqet të drejtën themelore të njeriut, e cila ka rol thelbësor në realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave të tjera. Mundësia për t'u shprehur në gjuhën time dhe për t'u shkëmbyer informacioni paraqet tregues të vlefshëm për kapacitetin demokratik dhe pozicionin institucional të demokracisë në shoqëri. Konceptet e qytetarisë dhe të pluralizmit janë të parealizueshme pa mundësinë e gjuhës, e shprehjes së lirë të mendimit dhe garës objektive të ideve të kundërvëna politike. Respektimi i gjuhës së tjetrit mundëson bashkekzistencë në shoqëritë bashkëkohore shumetnike, shumëgjuhësore dhe shumëkulturore.

Zbatimi i plotë i të drejtave të gjuhës shqipe në Republikën e Maqedonisë së Veriut është parakusht për qasje të barabartë në shërbime dhe pjesëmarrje efektive në jetën publike. Të drejtat e gjuhës janë të drejta për ta përdorur, ruajtur dhe promovuar identitetin e tyre gjuhësor për të gjithë brezat.

ÇFARË DUHET TË DINË QYTETARËT E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Gjuha na lejon të shprehim ide për të shkuarën, të tashmen dhe të ardhmen;

Gjuha është mjeti kryesor i komunikimit të njerëzve;

Gjuha është identiteti i një kombi;

Gjuha është i vetmi mjet i ndriçimit dhe përparimit moral;

Gjuha ruhet aty ku shkruhet;

Gjuha e tjetrit është pasuri kulturore për të gjithë;

Njohja e gjuhës së tjetrit është e drejtë themelore;

Respektimi i të drejtave gjuhësore është detyrim;

PSE DHE SI U KRIJUA AGJENCIA PËR ZBATIMIN E GJUHËS

Më 16 nëntor 2001, në seancë të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, janë miratuar amendamentet kushtetuese që burojnë nga Marrëveshja Kornizë e Ohrit, më saktësisht 15 amendamente kushtetuese, që duhet theksuar se paraqesin një frymë *sui generis* të rregullimit të marrëdhënieve ndërmjet bashkësive brenda shtetit. Zotimi i institucioneve të Republikës së Maqedonisë së Veriut për zbatimin e standardeve themelore ndërkombëtare, që garantojnë të drejtat gjuhësore është kodifikuar në kushtetutën e saj, gjë që këto instrumente i bën specifike ligjore ndërkombëtare drejtpërdrejt të zbatueshme.

Pas shumë përpjekjesh politike dhe juridike në vitin 2008 u soll Ligji për Përdorimin e Gjuhës, i cili duhet thënë se e avancoi gjuhën shqipe dhe përdorimin e saj në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe ishte një hap i rëndësishëm drejt fillimit të dygjuhësisë.

Ligji i tanishëm mbi Përdorimin e Gjuhëve, i cili hyri në fuqi me publikimin e tij në Gazetën Zyrtare (nr. 7/2019), vendos një bazë solide dhe të begatshme drejt barazisë së gjuhëve, i jep një dimension të ri shtetit dhe njëkohësisht paraqet një sfidë të veçantë për besueshmërinë në institucione dhe zhvillimin e mëtejshëm të demokracisë.

Me amendamentin V, rregullohet çështja e gjuhës dhe theksohet se rregullimi më i hollësishëm do të bëhet me ligj të veçantë. Është kjo baza juridike e cila shtroi rrugën për gjuhën shqipe drejt zyrtarizimit të saj si gjuhë institucionale.

Pas hyrjes në fuqi të këtij Ligji, u shpall konkursi publik për drejtor të Agjencisë për Zbatimin e Gjuhës, si rezultat i të cilit u emërua drejtori i parë i saj prof. dr. Ylber Sela më datë 24 shkurt 2019. Sekretariati i Përgjithshëm i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut caktoi Pleurat Ajazin dhe Armend Fazliun në shërbim të drejtorit për të ndjekur procedurat e nevojshme për themelimin e Agjencisë për Zbatimin e Gjuhës. Gjithashtu, në ekipin fillestar për të themeluar dhe konsoliduar Agjencinë për Zbatimin e Gjuhës kontribut kanë dhënë edhe tre këshilltarët e jashtëm të drejtorit, prof. dr. Izer Maksuti, prof. dr. Nuri Bexheti dhe prof. dr. Ajten Qamili si dhe bashkëpunëtorët Emer Mustafa, Berna Mejdiu, Lirim Shabani dhe Ariton Spahiu. Ky ishte ekipi fillestar me të cilin drejtori prof. dr. Ylber Sela menjëherë mbas emërimit filloi procedurat për regjistrimin e Agjencisë, përkatësisht më datë 13 mars 2019 Agjencia për Zbatimin e Gjuhës zyrtarisht fillon të ekzistojë dhe të konsolidohet si organ në suaza të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

MISIONI I AGJENCISË

Agjencia ka mision të ndihmojë praktikisht në zbatimin e Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve në institucionet shtetërore në përputhje të plotë me përcaktimet ligjore.

Të sqarojë, sugjerojë dhe udhëzojë me kompetencë në të gjitha rastet e nevojshme që shfaqen gjatë përdorimit të saj insitucional.

Të kujdeset për gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve (gjuhën shqipe).

Ta avancojë përdorimin zyrtar të gjuhës si një të drejtë elementare qytetare me anë të mekanizmave ligjorë dhe potencialit profesional të saj.

ROLI DHE FUSHËVEPRIMI I AGJENCISË

Ky institucion rrit ndërgjegjësimin publik në lidhje me të drejtat gjuhësore, për të mbështetur zbatimin efektiv të Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve; krijon siguri për të gjitha organet shtetërore, organet e administratës shtetërore, si dhe ndërmarrjet publike dhe komunale, me sukses ta zbatojnë Ligjin mbi Përdorimin e Gjuhëve në komunikimin e tyre me shkrim dhe me gojë.

- u jep mbështetje institucioneve për realizimin e obligimeve sipas këtij ligji duke përfshirë edhe përkthimin dhe lekturimin e dokumenteve;

- bën lekturimin e të gjitha akteve që botohen në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut;

- promovon dhe ndërmerr masa për avancimin e përdorimit të gjuhës të cilën e flasin së paku 20 për qind e qytetarëve (gjuhës shqipe);

- përgatit raporte për informimin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut në zbatimin e kompetencave të saj;

- përpilon materiale profesionale-analitike nga komeptencat e saj për nevojat e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë;

- jep mendimeve profesionale për materialet që janë të funksion të zbatimit dhe avancimit të përdorimit të gjuhës që e flasin së paku 20% e qytetarëve (gjuhës shqipe);

- si dhe bën punë të tjera që kanë të bëjnë me zbatimin e qëllimeve të përcaktuara me këtë ligj.

TË DREJTAT THEMELORE GJUHËSORE NË MAQEDONINË E VERIUT

Dygjuhësia – simbol kyç i shumetnisë së mirëfilltë
Qytetarët kanë të drejtën e përdorimit të gjuhëve zyrtare në nivel qendror:

- ta përdorin cilëndo nga gjuhët zyrtare në institucionet publike, organizatat dhe ndërmarrjet e tjera që kryejnë funksione publike në territorin e Maqedonisë së Veriut;

- në institucionet publike t'u lejohet të marrin informacione, shërbime dhe dokumente publike, kurse institucionet janë të obliguara t'i publikojnë të gjitha informacionet dhe dokumentet publike në ueb-faqen e tyre në dy gjuhë;

- në institucionet publike të shprehen lirshëm në njërën nga dy gjuhët zyrtare, njëkohësisht duke marrë informacione, shërbime a dokumente në gjuhën e tyre;

- të hartojnë dokumente a formularë në gjuhën që ka statusin e gjuhës në përdorim zyrtar;

- të kërkojnë që në letërnjoftimet, pasaportat ose ndonjë dokument tjetër të regjistrojnë dhe përdorin emrin, mbiemrin dhe të dhënat e tyre në gjuhën amtare;

- të kërkojnë shërbime në njërën nga dy gjuhët zyrtare gjatë pjesëmarrjes në procedura gjyqësore, para prokurorisë, policisë dhe shërbimeve e tjera. Ndërkaq, institucionet përkatëse janë të detyruara të sigurojnë shërbime në gjuhët zyrtare;

- në qoftë se u shkelen, cenohen ose mohohen të drejtat e tyre gjuhësore, kanë të drejtë të ankohen në institucionin përkatës.

Qytetarët kanë të drejtën e përdorimit të gjuhëve zyrtare në nivel lokal:

- ta përdorin cilëndo gjuhë zyrtare në komunat e vendit si dhe institucionet publike të komunave;

- në komunat ku gjuhë zyrtare është ajo që e flasin së paku 20% e qytetarëve (gjuha shqipe) ose me kërkesë me shkrim ose me gojë të komunikojnë, të marrin shërbime në dispozicion dhe dokumente publike nga institucionet dhe zyrtarët komunalë, në gjuhën që ka statusin zyrtar;

- në institucionet komunale t'u lejohet të marrin informacione, shërbime dhe dokumente publike, kurse institucionet janë të obliguara t'i publikojnë të gjitha informacionet dhe dokumentet publike në ueb-faqen e tyre në gjuhët zyrtare;

- institucionet komunale janë të obliguara që në të njëjtën kohë edhe t'i publikojnë të gjitha informacionet dhe dokumentet publike në formë elektronike dhe të shtypur në gjuhët zyrtare;

- në rregulloret dhe aktet e tjera juridike të miratuara nga komuna, si dhe në informacionet e tjera publike, t'u mundësohet qytetarëve të kenë qasje, ose nëse nuk kanë qasje, të mund të parashtrojnë kërkesë me shkrim ose me gojë në gjuhën që ka statusin zyrtar

SI DUHET TË JETË NË PRAKTIKË ZBATIMI I GJUHËVE:

- Institucionet publike janë të detyruara të ofrojnë informacione për publikun në gjuhët zyrtare.

- Qytetarët të trajtohen të barabartë në komunikim, në dokumente zyrtare, në takime publike, në ueb-faqet e institucioneve, emrat zyrtarë të qyteteve dhe fshatrave, rrugëve etj., në përputhje me Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve.

- Gjuhët në përdorim zyrtar në nivel komunal duhet të jenë në përputhje me kornizën ligjore, në shpalljen e konkurseve, shpalljeve të ndryshme, buletinëve etj., në përputhje me ligjin.

- Përdorimi i gjuhëve zyrtare të bëhet në rregulloret e komunës, tabelat, vulat, planin e punës, informacione për taksa komunale, projekte, plane urbanistike etj.

- Institucionet publike kanë të drejtë që në seanca të përdorin njërën nga gjuhët zyrtare, për të cilën mund të kërkohet edhe përkthim në gjuhë tjetër.

- Qytetarët kanë të drejtë të përdorin njërën nga gjuhët zyrtare gjatë shërbimeve që pranojnë gjatë përkujdesjes shëndetësore si p.sh.: në sportelet e informimit, në vizitë mjekësore të marrin të dhënat në gjuhën që kërkojnë, e cila duhet të jetë në njërën nga gjuhët zyrtare; gjithashtu udhëzimet te specialisti, recetat etj.

- Faturat nga kompanitë publike duhet të përdoren në të dyja gjuhët zyrtare .

- Formularët, aplikimet dhe dokumentet e tjera të ngjashme, që ofrojnë institucionet publike (në përdorim zyrtar) pranohen në gjuhën zyrtare që e kuptojnë (ose në gjuhën në përdorim zyrtar në nivel komunal) p.sh.: për aplikim në zyrën e punësimit, për parashtrimin e kërkesës për regjistrimin e biznesit, për regjistrimin e pronës etj.

MOHIMI I NJËRËS NGA DY GJUHËT ZYRTARE ËSHTË I NDALUAR


Në rastet kur konsiderohet se është mohuar, shkelur ose cenuar e drejta e gjuhës, qytetarët kanë të drejtën e ankesës në institucionin përkatës.

Diskriminimi në baza gjuhësore është i ndaluar dhe sanksionohet, si p.sh.: kur gjuha neglizhohet gjatë ofrimit të shërbimeve publike në administratë, organizatë ose ndërmarrje publike.

Mosrespektimi i gjuhës zyrtare në ndonjë dispozitë ligjore ose rregullore është i ndaluar, si p.sh.: Ligji duhet të shkruhet në dy gjuhë, vula të shkruhet në dy gjuhë, memorandumet po ashtu etj.

ANKESAT PËR DISKRIMINIM NË BAZA GJUHËSORE MUND TË PARASHTROHEN:

Në Agjencinë për Zbatimin e Gjuhës (ankesë e parashtruar gojarisht, me telefon; personalisht, në letër, në postë ose nëpërmjet postës elektronike të AZGJ-së.) (Adresa: "Shëtitorja Dimitar Vllahov" nr. 4, kati 4 - Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut; e-mail: ankesa@apj.gov.mk).



ANKESË

Në Inspektoratin për Zbatimin e Gjuhës (ankesë e parashtruar gojarisht, me telefon; personalisht; letër në postë ose nëpërmjet postës elektronike të Inspektoratit.

Në zyrën e Avokatit të Popullit (Adresa: Rr: "Maqedonia" 19; Tel: 02 3129 335; e-mail: contact@ombudsman.mk).

LIGJ PËR PËRDORIMIN E GJUHËVE

Neni 1

(1) Në tërë territorin në Republikën e Maqedonisë dhe në marrëdhëniet e saj ndërkombëtare gjuhë zyrtare është gjuha maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik.

(2) Gjuhë tjetër që e flasin së paku 20% e qytetarëve (gjuha shqipe), gjithashtu është gjuhë zyrtare dhe alfabeti i saj, në pajtim me këtë ligj.

(3) Në të gjitha organet e pushtetit shtetëror në Republikën e Maqedonisë, institucionet qendrore, ndërmarrjet publike, agjencitë, drejtoritë, entet dhe organizatat, komisionet, personat juridikë që kryejnë autorizime publike në pajtim me ligjin dhe institucionet tjera, gjuhë zyrtare krahas gjuhës maqedonase dhe alfabetit të saj është edhe gjuha që e flasin 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë dhe alfabeti i saj, në mënyrë të përcaktuar me këtë ligj.

(4) Në njësitë e vetëqeverisjes lokale gjuha dhe alfabeti që e shfrytëzojnë së paku 20% e qytetarëve është gjuhë zyrtare, krahas gjuhës maqedonase dhe alfabetit të saj cirilik. Për përdorimin e gjuhëve dhe alfabeteve në të cilat flasin më pak se 20% e qytetarëve në njësitë e vetëqeverisjes lokale, vendosin organet e njësive të vetëqeverisjes lokale.

Neni 2

(1) Qytetarët kanë të drejtë ta përdorin cilëndo nga gjuhët e theksuara zyrtare dhe alfabetet e tyre nga neni 1 paragrafët (1) dhe (2) të këtij ligji, ndërsa institucionet nga neni 1 paragrafi (3) të këtij ligji si dhe institucionet tjera e kanë për obligim që t'u mundësojnë qytetarëve shfrytëzim, përdorim dhe zbatim të atyre gjuhëve zyrtare dhe alfabeteve të tyre në cilëndo qoftë procedurë, si edhe zbatim të atyre procedurave në atë gjuhë zyrtare dhe në atë alfabet.

(2) Në pajtim me të drejtën e qytetarëve që ta përdorin cilëndo nga gjuhët e cekura zyrtare nga neni 1 paragrafët (1) dhe (2) të këtij ligji në procedurat gjyqësore, administrative, ekzekutive, procedurat parahetimore dhe hetimore, procedurat penale dhe për kundërvajtje, procedurat kontestimore dhe jashtëkontestimore, procedurat për ekzekutimin e sanksioneve, si dhe procedurat tjera të parapara me ligje tjera. Gjykatat, prokuroritë publike, si dhe të gjitha organet tjera, trupat dhe institucionet tjera janë të obliguara ta mundësojnë shfrytëzimin, përdorimin dhe zbatimin e cilësdo prej gjuhëve zyrtare nga neni 1 paragrafët (1) dhe (2) dhe alfabetet e tyre në ato procedura dhe procedura tjera.

(3) Në institucionet e pushtetit shtetëror në Republikëne e Maqedonisë nga neni 1 paragrafi (3) i këtij ligji, gjuhë zyrtare krahas gjuhës maqedonase dhe alfabetit të saj është edhe gjuha të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë dhe alfabeti i saj në: komunikim, përdorim dhe zbatim në të gjitha procedurat e qytetarëve para të gjitha organeve të cilat e përbëjnë pushtetin shtetëror (Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, Presidenti i Republikës së Maqedonisë, Qeveria e Republikës së Maqedonisë, gjyqësia, prokuroria publike), Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë, Avokatii Popullit i Republikës së Maqedonisë, në procesin zgjedhor, arsim, shkencë, shëndetësi, kulturë, gjatë zbatimit të autorizimeve policore, në veprimtarinë radiodifuzive, noteri, përmbarim, objekte infrastrukturore, evidencën e amzës, dokumentet personale, financat, ekonomi, si dhe në sferat tjera.

Neni 3

Funksionarë të zgjedhur ose të emëruar të institucioneve nga neni 1 paragrafi (3) dhe neni 2 paragrafi (3) të këtij ligji, si dhe institucionet tjera selia e të cilave është në Shkup ose komunat në të cilat së paku 20% e qytetarëve flasin gjuhë të ndryshme nga gjuha maqedonase, në komunikimin e tyre zyrtar e përdorin gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik, si dhe gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe alfabetin e saj, nëse së paku njëri prej funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar flet gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase.

Neni 4

(1) Në punën e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë gjuhë zyrtare është gjuha maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik, si dhe gjuha të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë dhe alfabeti i saj.

(2) Deputeti, funksionari i zgjedhur ose i emëruar që flet gjuhë të ndryshme nga gjuha maqedonase, e të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë, në seancën e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë dhe në mbledhjet e trupave punues flet edhe në gjuhën të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë.

(3) Deputeti, që flet gjuhë të ndryshme nga gjuha maqedonase, e të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë kur kryeson me seancën e Kuvendit ose me mbledhjet e trupave punues, të njëjtat i kryeson në atë gjuhë.

(4) Deputeti, funksionari i zgjedhur ose i emëruar që flet gjuhë të ndryshme nga gjuha maqedonase, e të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë, materialet i merr në kohë, përkatësisht i dorëzon edhe në gjuhën dhe alfabetin e tij që të shërbejnë në seancë të Kuvendit ose në mbledhje të trupave punues.

(5) Stenogramet nga seanca e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë dhe nga mbledhjet e trupave punues, si dhe materialet dhe dokumentet tjera lëshohen dhe ruhen në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj dhe në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë dhe në alfabetin e saj.

(6) Të gjitha ligjet dhe aktet tjera të miratuara nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë publikohen në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik dhe në gjuhën të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë dhe alfabetin e saj.

Neni 5

(1) Në punën e Qeverisë të Republikës së Maqedonisë gjuhë zyrtare është gjuha maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik, si dhe gjuha të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë dhe alfabeti i saj.

(2) Seancat e Qeverisë të Republikës së Maqedonisë kryesohen në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik.

(3) Kur me seancat e Qeverisë të Republikë së Maqedonisë, me mbledhjet e komisioneve, si dhe me Kolegjiumin e përgjithshëm të sekretarëve shtetërorë kryeson funksionar i zgjedhur ose i emëruar që flet gjuhë të ndryshme nga gjuha maqedonase, e të cilën gjuhë e flasin së paku 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë, të njëjtat i kryeson në atë gjuhë dhe alfabet.

(4) Funksionari i zgjedhur ose i emëruar që flet gjuhë të ndryshme nga gjuha maqedonase, e të cilën gjuhë e flasin së paku 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë, në komisionet dhe në Kolegjiumin e përgjithshëm të sekretarëve shtetërorë flet edhe në atë gjuhë.

(5) Funksionari i zgjedhur ose i emëruar që flet gjuhë të ndryshme nga gjuha maqedonase, e të cilën gjuhë e flasin së paku 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë, materialet i merr në kohë, përkatësisht i dorëzon edhe në gjuhën dhe alfabetin e tij që t'i shërbejnë në seancë të Qeverisë të Republikës së Maqedonisë, në komisionet dhe në Kolegjiumin e përgjithshëm të sekretarëve shtetërorë.

(6) Stenogramet nga seanca e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, nga mbledhja e komisioneve dhe Kolegjiumi i përgjithshëm i sekretarëve shtetërorë, si dhe materialet dhe dokumentet tjera lëshohen dhe ruhen në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj dhe në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë dhe në alfabetin e saj.

(7) Të gjitha aktet e miratuara nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë lëshohen dhe publikohen në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik dhe në gjuhën të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë dhe alfabetin e saj.

Neni 6

(1) Institucionet nga neni 1 paragrafi (3) dhe neni 2 paragrafi (3) të këtij ligji, si dhe të gjitha institucionet tjera janë të obliguara me detyrë zyrtare të sigurojnë që përdorimi, komunikimi dhe procedurat të zhvillohen në gjuhën të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë dhe alfabetin e saj, nëse personi, përkatësisht pjesëmarrësi flet gjuhë të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë.

(2) Të gjitha vendimet dhe aktet e tjera, si dhe legjitimacionet që dalin nga kompetenca e institucioneve nga neni 1 paragrafi (3) dhe neni 2 paragrafi (3) i këtij ligji, si dhe të gjitha institucioneve tjera, janë në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik dhe në gjuhën të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë dhe alfabetin e saj nëse personi, përkatësisht pjesëmarrësi flet gjuhë të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë.

(3) Personi i zgjedhur ose i emëruar që flet gjuhë të ndryshme nga gjuha maqedonase, të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë, emrin personal në vendimet dhe aktet tjera në kuadër të kompetencave të institucioneve nga neni 1 paragrafi (3) dhe neni 2 paragrafi (3) të këtij ligji, si edhe në të gjitha institucionet tjera, e shkruan në gjuhën dhe alfabetin e tij

(4) Ueb faqet e institucioneve nga neni 1 i këtij ligji dhe përmbajtja e ueb faqeve krahas gjuhës maqedonase dhe alfabetit të saj, detyrimisht publikohen edhe në gjuhë të ndryshme nga gjuha maqedonase të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë dhe alfabetin e saj.

Neni 7

(1) Emrat e institucioneve nga neni 1 paragrafi (3) dhe neni 2 paragrafi (3) të këtij ligji, si dhe të të gjitha institucioneve tjera dhe njësive të tyre rajonale në njësitë e vetëqeverisjes lokale në të cilën së paku 20% e qytetarëve flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase edhe në Shkup, do të shkruhen në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik dhe në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe alfabetin e saj, si dhe në gjuhën angleze.

Emrat do të jenë me madhësi dhe font të njëjtë, me ç'rast emri në gjuhën maqedonase dhe me alfabetin e saj do të shkruhet i pari.

(2) Në zyrat rajonale të organeve të administratës shtetërore që mbulojnë së paku një njësi të vetëqeverisjes lokale në të cilën së paku 20% e qytetarëve flasin gjuhë të ndryshme nga maqedonishtja, emrat e zyrave do të shkruhen në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik dhe në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe alfabetin e saj.

(3) Vulat e institucioneve nga neni 1 paragrafi (3) dhe neni 2 paragrafi (3) të këtij ligji dhe të të gjitha institucioneve tjera me seli në Shkup apo në njësitë e vetëqeverisjes lokale në të cilën së paku 20% e qytetarëve flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase, janë të shkruara në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik, si dhe në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe alfabetin e saj.

(4) Institucionet nga paragrafi 1 i këtij neni do të mundësojnë dhe kontribuojnë që në punë në mënyrë efektive të shfrytëzohen, përdoren dhe zbatohen gjuha maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik dhe gjuha që e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe alfabeti i saj.

Neni 8

(1) Kartëmonedhat dhe monedhat, si dhe pullat postare do të përmbajnë simbole që e përfaqësojnë trashëgiminë kulturore të qytetarëve që e flasin gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik dhe gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe alfabetin e saj.

(2)Pullat postare, fletëpagesat, raportet fiskale të lëshuara nga institucionet nga neni 1 paragrafi (3) dhe neni 2 paragrafi (3) të këtij ligji, faturat e institucioneve nga neni 1 paragrafi (3) dhe neni 2 paragrafi (3) të këtij ligji, banderolat, shkruhen në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik dhe gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe alfabetin e saj.

(3) Uniformat e policisë, të zjarrfikësve, të shëndetësisë; në Shkup dhe në komunat në të cilat së paku 20% e qytetarëve flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase janë të shkruara në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik, si dhe në gjuhën që e flasin së paku 20% të qytetarëve në Republikën e Maqedonisë dhe alfabetin e saj.

Neni 9

(1) Në procedurat gjyqësore, administrative, ekzekutive, procedurat për ekzekutimin e sanksioneve, procedurat parahetimore dhe hetimore, procedurat penale dhe të kundërvajtjes, procedurat kontestimore dhe jashtëkontestimore, si dhe procedurat tjera para gjykatave, prokurorive publike, si dhe të gjitha organeve, trupave dhe institucioneve, zbatohet gjuha maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik, si dhe gjuha që e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe alfabeti i saj.

(2) Të gjitha procedurat nga paragrafi (1) i këtij neni mbahen në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik dhe në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve nëRepublikën e Maqedonisë dhe alfabetin e saj, nëse gjykatësi, prokurori publik, pala apo pjesëmarrësi tjetër në procedurë është person që flet gjuhë, të cilën e flasin së paku 20% të qytetarëve në Republikën e Maqedonisë.

(3) Të gjitha vendimet, shkresat dhe aktet tjera që dalin nga procedurat nga paragrafi (1) i këtij neni miratohen dhe botohen në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik, si dhe në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe alfabetin e saj nëse gjykatësi, prokurori publik, pala apo pjesëmarrësi tjetër në procedurë është person që e flet gjuhë, të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë.

(4) Institucionet e theksuara në paragrafin (1) të këtij neni obligohen që të mundësojnë përkthim të të gjitha dokumenteve dhe materialeve të nevojshme, si dhe përkthim simultan të ekspozeve, deklaratave dhe seancave gjyqësore në punën apo procedurat që mbahen.

(5) Mossigurimi i përkthimit të të gjitha dokumenteve dhe materialeve të nevojshme, përkatësisht mossigurimi i përkthimit simultan gjatë tërë kohëzgjatjes së procedurës paraqet shkelje esenciale të procedurës.

(6) Emrat e institucioneve të theksuara në paragrafin (1) të këtij neni në Shkup dhe në njësitë e vetëqeverisjes lokale në të cilën së paku 20% e qytetarëve flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase shkruhen në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik dhe në gjuhën që e flasin së paku 20% të qytetarëve dhe alfabetin e saj.

(7) Në institucionet e theksuara në paragrafin (1) të këtij neni me seli në rajonin që përfshin më shumë gjykata themelore prej të cilave së paku njëra prej tyre gjendet në njësinë e vetëqeverisjes lokale në të cilën flitet gjuhë zyrtare e ndryshme nga maqedonishtja, e të cilën e flasin 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë, emrat gjithashtu do të shkruhen në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik dhe në gjuhën që e flasin së paku 20% të qytetarëve dhe alfabetin e saj.

(8) Shpenzimet që krijohen nga përkthimi për palët dhe pjesëmarrësit në procedurë, si dhe shpenzimet për përkthyes gjyqësor që krijohen me zbatimin e dispozitave të këtij ligji, janë barrë e mjeteve të institucioneve të theksuara në paragrafin (1) të këtij neni.

Neni 10

(1) Në procedurat para noterit, dokumentet noteriale dhe verifikimet mund të lëshohen në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj dhe në gjuhën që e flasin së paku 20% të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë dhe alfabetin e saj.

(2) Në procedurat para përmbaruesit, nëse pjesëmarrësi është person që e flet gjuhën të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë, urdhëresat, konkluzionet, procesverbalet, shënimet zyrtare dhe aktet tjera të përmbaruesve lëshohen në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj dhe në gjuhën që e flasin së paku 20% të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë dhe alfabetin e saj.

Neni 11

(1) Institucionet kompetente për menaxhim me institucionet për ekzekutimin e sanksioneve, si dhe vetë institucionet kompetente për ekzekutimin e sanksioneve obligohen që në komunikim dhe në procedura ta zbatojnë gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj, si dhe gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe alfabetin e saj nëse personi për të cilin bëhet fjalë flet gjuhë që e flasin së paku 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë.

(2) Institucionet kompetente për menaxhim me institucionet për ekzekutimin e sanksioneve si dhe institucionet kompetente për ekzekutimin e sanksioneve obligohen të mundësojnë që personat të cilët gjenden në këto institucione të flasin edhe në gjuhën që e flasin së paku 20% të qytetarëve dhe alfabetin e saj.

Neni 12

(1) Evidencat e amzës në Shkup dhe në njësitë e vetëqeverisjes lokale në të cilat së paku 20% e qytetarëve flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga maqedonishtja mbahen edhe në gjuhën zyrtare që e flet qytetari.

(2) Aktvendimet, certifikatat, vërtetimet si dhe aktet tjera botohen edhe në gjuhën zyrtare që e flet qytetari.

(3) Dokumentet personale dhe dokumentet e udhëtimit të qytetarëve që flasin në gjuhën të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe alfabetin e saj, me detyrë zyrtare lëshohen në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik dhe gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe alfabetin e saj.

Neni 13

(1) Për qytetarët që flasin gjuhë të ndryshme nga gjuha maqedonase, të cilën e flasin më pak se 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë, formulari i letërnjoftimit shtypet edhe në gjuhën dhe alfabetin që e përdor qytetari.

(2)Për qytetarët që flasin gjuhë të ndryshme nga gjuha maqedonase, të cilën e flasin më pak se 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë, me kërkesë të tyre personale, të dhënat për emrin personal që shënohen në letërnjoftim shkruhen në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik dhe në gjuhën dhe alfabetin që e përdor qytetari.

Neni 14

(1)Për qytetarët që flasin gjuhë të ndryshme nga gjuha maqedonase, të cilën e flasin më pak se 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë, me kërkesë të tyre, formulari i dokumentit të udhëtimit dhe fletudhëtimi shtypet edhe në gjuhën dhe alfabetin që e përdor qytetari.

(2) Për qytetarët që flasin gjuhë të ndryshme nga gjuha maqedonase, të cilën e flasin më pak se 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë, me kërkesë të tyre personale, të dhënat që shënohen në dokumentin e udhëtimit dhe në fletudhëtim shkruhen edhe në atë gjuhë dhe alfabet.

(3) Për qytetarët që flasin gjuhë të ndryshme nga gjuha maqedonase, të cilën e flasin më pak se 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë, me kërkesë të tyre personale, të dhënat për emrin personal që shënohen në dokumentin e udhëtimit shkruhen edhe në gjuhën dhe alfabetin që e përdor qytetari.

Neni 15

Në mbledhjet e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe të komisioneve komunale të zgjedhjeve në Shkup dhe njësitë e vetëqeverisjes lokale, në të cilat së paku 20% e qytetarëve flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase, gjatë realizimit të zgjedhjeve, në punën dhe procedurat e të gjitha komisioneve dhe trupave dhe institucioneve tjera, në mënyrë të barabartë shfrytëzohen, përdoren dhe zbatohen gjuha maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik dhe gjuha që e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe alfabeti i saj.

Neni 16

(1) Emri i rrugës, sheshit, urës dhe i objektit tjetër infrastrukturor në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes lokale ku së paku 20% e qytetarëve flasin gjuhë të ndryshme nga gjuha maqedonase, si dhe në Shkup, shkruhet në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik, si dhe në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe alfabetin e saj, si dhe në gjuhët që janë të pranuara përgjithësisht nga bashkësia ndërkombëtare.

(2) Në vendkalimet kufitare të Republikës së Maqedonisë dhe aeroportet që gjenden në rajonin ku së paku 20% e qytetarëve flasin gjuhë të ndryshme nga gjuha maqedonase, emrat e institucioneve, mbishkrimet tjera dhe udhërrëfyesit shkruhen në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj, si dhe në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe alfabetin e saj.

Neni 17

(1) Të gjitha ligjet, aktet nënligjore, vendimet dhe shpalljet e institucioneve nga neni 1 paragrafi (3) dhe neni 2 paragrafi (3) të këtij ligji, që botohen në Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë, botohen në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj dhe në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe alfabetin e saj.

Neni 18

(1) Për realizimin e qëllimeve të këtij ligji, për promovimin, mbrojtjen dhe zbatimin e barabartë të gjuhës zyrtare që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë dhe alfabetit të saj, themelohet Agjencia për Zbatimin e Gjuhës që e Flasin së paku 20% e Qytetarëve të Republikës së Maqedonisë (në tekstin e mëtejshëm: Agjencia) me cilësinë e personit juridik, kompetente për standardizimin dhe përdorimin e barabartë të gjuhës të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë dhe alfabetit të saj me trupat ndihmëse për mbështetjen e institucioneve nga neni 1 paragrafi (3) dhe neni 2 paragrafi (3) të këtij ligji, si dhe të gjitha institucioneve tjera.

(2) Drejtorin e Agjencisë e zgjedh Qeveria e Republikës së Maqedonisë me thirrje publike të shpallur paraprakisht, me mandat prej 4 vitesh me të drejtë rizgjedhjeje.

(3) Në Agjenci, krahas përkthyesve të autorizuar gjyqësorë punësohen edhe linguistë dhe filologë të diplomuar të gjuhës shqipe, si dhe lektorë të licencuar.

(4) Drejtori e përfaqëson Agjencinë, udhëheq me punën e saj, i kryen punët e përcaktuara me këtë ligj dhe miraton program vjetor për punën e Agjencisë. Drejtori paraqet raport për punën e Agjencisë në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së paku një herë në vit deri më 31 mars në vitin rrjedhës për vitin paraprak.

(5)Mjetet për punën dhe funksionimin e Agjencisë sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

Neni 19

Agjencia është kompetente për: - dhënien e mbështetjes institucioneve në realizimin e obligimeve që burojnë nga ky ligj, duke përfshirë përkthimin dhe lekturimin e dokumenteve; - lekturimin e të gjitha akteve që botohen në Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë; - promovimin dhe marrjen e masave për avancimin e përdorimit të gjuhës që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë; - hartimin e raporteve për informimin e Qeverisë të Republikës së Maqedonisë për zbatimin e kompetencave të saj;

- përgatitjen e materialeve analitike-profesionale nga kompetenca e saj për nevojat e Qeverisë të Republikës së Maqedonisë; - dhënien e mendimeve profesionale për materialet që janë në funksion të zbatimit dhe avancimit të përdorimit të gjuhës që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë; - punë të tjera lidhur me zbatimin e qëllimeve të përcaktuara në këtë ligj.

Neni 20

(1) Për mbikëqyrje mbi zbatimin e plotë dhe konsekuent të dispozitave të këtij ligji që kanë të bëjnë me përdorimin e gjuhëve, themelohet Inspektorati për Përdorimin e Gjuhëve (në tekstin e mëtejshëm: Inspektorati), në përbërje të Ministrisë së Drejtësisë me cilësi të personit juridik.

(2)Parimet, kompetenca, organizimi i inspektimit dhe procedurat e mbikëqyrjes inspektuese të Inspektoratit për Përdorimin e Gjuhëve rregullohen me ligj të veçantë.

Neni 21

Qeveria e Republikës së Maqedonisë dhe të gjitha institucionet kompetente për zbatimin e dispozitave të këtij ligji, do të miratojnë masa për promovimin e zbatimit të të gjitha gjuhëve zyrtare, si dhe për garantimin e mbrojtjes së gjuhëve të bashkësive tjera, gjuha amtare e të cilave nuk është gjuhë zyrtare.

Neni 22

(1) Gjobë në shumë prej 4.000 deri në 5.000 euro në kundërvlerë me denarë për kundërvajtje do t'u shqiptohet organeve të theksuara në nenin 1 paragrafi (3), nenin 2 paragrafi (3), si dhe të gjitha institucioneve tjera për mosrespektimin e dispozitave të këtij ligji.

(2) Gjobë në shumë prej 30% të gjobës së përcaktuar do t'i shqiptohet personit zyrtar dhe personit përgjegjës në organet nga paragrafi 1 i këtij neni.

Neni 23

(1) Në afat prej një viti nga dita e hyrjes në fuqi e këtij ligji, të gjitha institucionet kompetente obligohen që t'i miratojnë aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji.

(2) Në afat prej gjashtë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi e këtij ligji, institucionet obligohen t'i zbatojnë obligimet e theksuara në nenin 7 të këtij ligji.

(3) Qeveria e Republikës së Maqedonisë menjëherë pas hyrjes në fuqi të këtij ligji do të zhvillojë program për ngritjen e vetëdijes publike për zbatimin e këtij ligji.

(4) Në afat prej një viti, dispozitat e ligjeve tjera harmonizohen me dispozitat e këtij ligji.

(5) Në rast të mosharmonizimit të dispozitave të këtij ligji me dispozitat gjuhësore të ligjit tjetër, organet kanë për detyrë t'i zbatojnë dispozitat e këtij ligji.

Neni 24

Me miratimin e këtij ligji shfuqizohet Ligji për përdorimin e gjuhës që e flasin së paku 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë dhe në njësitë e vetëqeverisjes lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 101/08 dhe 100/11).

Neni 25

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

LIGJI I INSPEKTORATIT MBI PËRDORIMIN E GJUHËVE

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë ligj rregullohen kompetencat, organizimi dhe procedurat e mbikëqyrjes inspektuese të Inspektoratit.

Neni 2

Qëllimi i këtij ligji është organizimi i sistemit efikas të mbikëqyrjes inspektuese mbi zbatimin e Amendamentit V të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut, si dhe të dispozitave të Ligjit për përdorimin e gjuhëve në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Neni 3

(1) Punët e mbikëqyrjes inspektuese nga sfera e zbatimit të Amendamentit V të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe të dispozitave të Ligjit për përdorimin e gjuhëve, i kryen Inspektorati për Përdorimin e Gjuhëve (në tekstin e mëtejmë: Inspektorati) si organ në përbërje të Ministrisë së Drejtësisë (në tekstin e mëtejmë: Ministria).

(2) Inspektorati ka cilësinë e personit juridik.

Neni 4

Në procedurën gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese do të zbatohen dispozitat dhe parimet e Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative dhe Ligjit për mbikëqyrje inspektuese, nëse me këtë ligj nuk është rregulluar ndryshe.

Përdorimi i gjuhëve dhe i alfabeteve

Neni 5

Dispozitat e Ligjit për përdorimin e gjuhëve, gjatë mbikëqyrjes inspektuese, zbatohen në mënyrë përkatëse.

II. KOMPETENCA

Neni 6

(1) Inspektorati kryen mbikëqyrje inspektuese mbi zbatimin e Amendamentit V të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe të dispozitave të Ligjit për përdorimin e gjuhëve në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nga të gjitha institucionet kompetente (në tekstin e mëtejmë: subjekt i mbikëqyrjes inspektuese.)

(2) Mbikëqyrja nga paragrafi (1) i këtij neni përfshin:

- mbikëqyrje mbi zbatimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve në procedurat para institucioneve,

-mbikëqyrje mbi emërtimet dhe vulat e institucioneve,

-mbikëqyrje mbi emrat e objekteve infrastrukturore,

-mbikëqyrje mbi publikimin e ligjeve, të akteve nënligjore, vendimeve dhe shpalljeve në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut", dhe

-punë të tjera të përcaktuara me ligj, e të cilat kanë të bëjnë me zbatimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve.

III. ORGANIZIMI

Neni 7

(1) Inspektorati, punët në kompetencë të vet i kryen nëpërmjet:

-drejtorit të Inspektoratit (në tekstin e mëtejmë: Drejtori),

-inspektorëve për mbikëqyrje mbi përdorimin e gjuhëve (në tekstin e mëtejmë: Inspektorët) dhe

-të punësuarve tjerë në Inspektorat.

(2) Për kryerjen e punëve të caktuara profesionale, administrative dhe ndihmëse në kompetencë të Inspektoratit formohen forma të brendshme përkatëse organizative.

(3) Drejtori i Inspektoratit miraton akte për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Inspektorat.

Neni 8

(1) Me punët e Inspektoratit udhëheq drejtori.

(2) Drejtorin e Inspektoratit e emëron dhe shkarkon Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(3) Drejtori emërohet për periudhë kohore prej katër vitesh me të drejtë për një rizgjedhje.

(4) Drejtori i Inspektoratit zgjidhet nëpërmjet konkursit publik, i cili duhet të publikohet në së paku dy gazeta ditore, që botohen në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, prej të cilave në një nga gazetat që botohen në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve që flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase.

(5) Drejtor i Inspektoratit mund të emërohet personi i cili i plotëson kushtet si vijojnë:

1.ka shtetësi të Republikës së Maqedonisë së Veriut;

2.në momentin e emërimit me vendim të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar dënim me burg ose sanksion për kundërvajtje ndalim për ushtrimin e profesionit, veprimtarisë ose detyrës;

3.ka fituar së paku 240 kredi sipas SETK ose shkallën e kryer VII/1;

4.ka së paku gjashtë vjet përvojë pune pas diplomimit, në fushën përkatëse;

5.posedon një nga certifikatat ose dëshmitë e pranuara ndërkombëtarisht për njohjen aktive të gjuhës angleze: - TOEFL IBT – së paku 74 pikë, IELTS (IELTS) - së paku 6 pikë, -ILEC (ILEC) (Cambridge English: Legal) – së paku niveli B2 (B2), FCE (FCE) (Cambridge English: First) – të kaluar, BULATS (BULATS) – së paku 60 pikë ose APTIS (APTIS) së paku nivelin B2 dhe

6.posedon vërtetim për njohjen aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë.

Neni 9

(1) Drejtori mund të shkarkohet para skadimit të mandatit për të cilin është emëruar, në pajtim me Ligjin.

Neni 10

(1) Drejtori i kryen punët si në vijim:

1) e koordinon dhe organizon punën e Inspektoratit;

2) e prezanton dhe përfaqëson Inspektoratin;

3) ndërmerr veprime juridike në emër dhe për llogari të Inspektoratit;

4) siguron kushte për zbatimin efikas të ligjeve dhe dispozitave të cilat kanë të bëjnë me mbikëqyrjen inspektuese;

5) vendos për të drejtat dhe obligimet e të punësuarve në Inspektorat;

6) siguron kushte për përsosje profesionale dhe trajnim të specializuar të inspektorëve;

7) miraton akte për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Inspektorat;

8) miraton dokumente programore dhe raportuese, duke përfshirë:

-plan strategjik të Inspektoratit,

- program vjetor për punën e Inspektoratit,

- program vjetor për trajnim të specializuar të inspektorëve,

- raport gjashtëmujor për punën e çdo inspektori,

- plan mujor për punën e çdo inspektori,

- dokumente dhe akte tjera të parashikuara me këtë ligj ose ligj tjetër;

9) siguron transparencë në punën e Inspektoratit dhe

10) kryen punë të tjera në kompetencë të Inspektoratit, në pajtim me Ligjin.

(2) Drejtorin, në mungesë të tij ose kur për shkak të sëmundjes ose për shkaqe tjera, nuk ka mundësi ta ushtrojë funksionin, e zëvendëson një nga inspektorët udhëheqës, i autorizuar nga drejtori.

Neni 11

(1) Vendet e punës të inspektorëve klasifikohen në dy kategori, si në vijim:

-Kategoria B - inspektorë udhëheqës dhe

-Kategoria V - inspektorë.

(2) Në kuadër të secilës kategori nga paragrafi (1) i këtij neni, përcaktohen më shumë nivele të vendeve të punës të inspektorëve.

Nivelet e vendeve të punës të inspektorëve të kategorisë B-inspektorë udhëheqës

(3) Në kuadër të kategorisë B - inspektorë udhëheqës, përcaktohen këto nivele të vendeve të punës të inspektorëve:

B1 – inspektor udhëheqës i nivelit të parë, B2 – inspektor udhëheqës i nivelit të dytë,

B3 – inspektor udhëheqës i nivelit të tretë dhe B4 – inspektor udhëheqës i nivelit të katërt.

(4) Inspektori udhëheqës i kategorisë B, për vendin e punës, duhet t'i plotësojë kushtet e posaçme si në vijim:

a) kualifikime profesionale për të gjitha nivelet - së paku 240 kredi të fituara sipas SETK ose shkallën VII/1 të mbaruar;

b) përvojë pune, si në vijim:

- për nivelin B1 - së paku dhjetë vjet përvojë pune në fushën që ka kompetencë shërbimin inspektues, prej të cilave së paku pesë vjet në vendin e punës në nivelin V1,

- për nivelin B2 - së paku tetë vjet përvojë në fushën që ka kompetencë shërbimin inspektues, prej të cilave së paku tre vjet në vendin e punës në nivelin V1,

- për nivelin B3 - së paku gjashtë vjet përvojë pune në fushën që ka kompetencë shërbimin inspektues, prej të cilave së paku dy vjet në vendin e punës në nivelin V1 dhe

- për nivelin B4 - së paku katër vjet përvojë pune në fushën që ka kompetencë shërbimin inspektues, prej të cilave së paku një vit në vendin e punës në nivelin V1;

c) kompetenca të përgjithshme pune për të gjitha nivelet, në pajtim me Kornizën për kompetenca të përgjithshme;

ç) kompetenca të veçanta pune për të gjitha nivelet, të posedojë vërtetim për njohje të programeve kompjuterike për punë në zyrë dhe

d) për të gjitha nivelet të ketë licencë inspektori nga fusha që ka kompetencë shërbimin inspektues.

Neni 12

1) Në kuadër të kategorisë së inspektorëve – V, përcaktohen këto nivele të vendeve të punës të inspektorëve:

-V1 - inspektor i nivelit të parë,

-V2 - inspektor i nivelit të dytë,

-V3 – inspektor i nivelit të tretë dhe

-V4 – inspektor i nivelit të katërt.

(2) Inspektori i kategorisë V duhet t'i plotësojë këto kushte të veçanta për vendin e punës:

a) kualifikime profesionale për të gjitha nivelet – së paku 240 kredi të fituara sipas SETK ose shkallën VII/1 të mbaruar;

b) përvojë pune, si në vijim:

- për nivelin V1 – së paku tre vjet përvojë pune në fushën që ka kompetencë shërbimin inspektues, prej të cilave dy vjet në vendin e punës të nivelit V2,

- për nivelin V2 - së paku dy vjet përvojë pune në në fushën që ka kompetencë shërbimin inspektues, prej të cilave një vit në vendin e punës të nivelit V3,

- për nivelin V3 - së paku një vit përvojë pune në fushën që ka kompetencë shërbimin inspektues dhe

- për nivelin V4 – me ose pa përvojë pune;

c) kompetenca të përgjithshme të punës për të gjitha nivelet, në pajtim me Kornizën e kompetencave të përgjithshme të punës;

ç) kompetenca të veçanta pune për të gjitha nivelet, të posedojë vërtetim për njohjen e programeve kompjuterike për punë në zyrë dhe

d) për nivelet V1, V2 dhe V3 të ketë licencë për inspektor nga fusha që ka kompetencë shërbimin inspektues.

Neni 13

(1) Për inspektorët, nivelet në kuadër të kategorive në mënyrë plotësuese përshkruhen me titull, si në vijim:

-B1 - inspektor i përgjithshëm,

-B2 - kryeinspektor,

-B3 – ndihmës kryeinspektor,

-B4 - inspektor i lartë,

-V1 – inspektor këshilltar,

-V2 – inspektor i pavarur,

-V3 – ndihmësinspektor dhe

-V4 – inspektor i ri.

Neni 14

Lëshimi i licencave dhe trajnimet për pajisje me licenca për inspektor, zbatohen në pajtim me dispozitat e Ligjit për mbikëqyrje inspektuese.

Neni 15

(1) Raportin për punën e Inspektoratit për gjashtë muajt paraprakë, e përgatit drejtori, më së voni deri më 15 korrik për periudhën janar-qershor në vitin rrjedhës, përkatësisht më së voni deri më 15 janar për periudhën korrik-dhjetor nga viti paraprak, dhe dorëzohet për miratim në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(2) Raporti nga paragrafi (1) i këtij neni, për punën e Inspektoratit, më së voni deri më 31 korrik përkatësisht 31 janar, i dorëzohet Këshillit Inspektues, në formë elektronike dhe në formë të shkruar.

(3) Raporti nga paragrafi (1) i këtij neni, veçanërisht përmban:

- vlerësim të gjendjeve nga aspekti i ligjshmërisë së akteve,

- të dhëna për numrin e mbikëqyrjeve të kryera dhe shkeljeve të konstatuara,

- të dhëna për aktvendime të miratuara,

- rekomandime për përmirësimin e gjendjeve të konstatuara dhe

- të dhëna të tjera me rëndësi për punën e Inspektoratit.

(4) Raporti vjetor nga paragrafi (1) shpallet në ueb faqen e Inspektoratit.

Neni 16

Drejtori përgatit propozim-programin vjetor për punën e Inspektoratit dhe të njëjtin e dorëzon në Këshillin Inspektues për marrje të pëlqimit, më së voni deri më 30 shtator në vitin rrjedhës për vitin e ardhshëm.

(2) Drejtori e miraton planin vjetor për punën e Inspektoratit në afat prej shtatë ditësh nga dita e marrjes së pëlqimit nga paragrafi (1) i këtij neni, përkatësisht më së voni deri më 10 dhjetor të vitit rrjedhës, nëse Këshilli Inspektues nuk e shqyrton dhe nuk e dorëzon pëlqimin, përkatësisht vërejtjet në afatin e paraparë.

(3) Në bazë të programit të miratuar vjetor, drejtori përpilon plane tremujore për punën e secilit inspektor të cilat në formë të përmbledhur i parashtron për shqyrtim në Këshillin Inspektues, më së voni dy javë para fillimit të tremujorit të ardhshëm kalendarik dhe atë deri më 15 dhjetor për tremujorin e parë të vitit të ardhshëm, deri më 15 mars për të dytin, deri më 15 qershor për të tretin, përkatësisht deri më 15 shtator për tremujorin e katërt në vitin rrjedhës.

(4) Në planet tremujore për punën e secilit inspektor, drejtori detyrimisht e shënon numrin e mbikëqyrjeve të planifikuara në tre muajt e ardhshëm, si dhe shkallën e kompleksitetit të secilës prej mbikëqyrjeve.

(5) Në bazë të planeve tremujore për secilin inspektor, drejtori përpilon plan mujor për punë, plan i cili përmban edhe orar të mbikëqyrjeve deri në data dhe sipas subjekteve të mbikëqyrjes.

(6) Drejtori, më së voni dy javë nga fillimi i tremujorit rrjedhës kalendarik për atë paraprak në Këshillin Inspektues, në formë të përmbledhur parashtron raporte tremujore për punën e secilit inspektor dhe atë, deri më 15 janar për tremujorin e katërt të vitit paraprak, deri më 15 prill për tremujorin e parë, deri më 15 korrik për të dytin, përkatësisht deri më 15 tetor për tremujorin e tretë në vitin rrjedhës.

(7) Drejtori më së voni deri më 1 mars të vitit rrjedhës në Këshillin Inspektues parashtron raport vjetor për punë të Inspektoratit për vitin paraprak.

IV. MBIKËQYRJA INSPEKTUESE

Neni 17

Inspektori në mënyrë të pavarur i kryen punët e mbikëqyrjes inspektuese dhe merr masa për të

cilat është i autorizuar me këtë Ligj dhe dispozitat e Ligjit për mbikëqyrje inspektuese.

Neni 18

(1) Inspektori, cilësinë e tij, identitetin dhe autorizimin për kryerje të mbikëqyrjes inspektuese e dëshmon me legjitimacion zyrtar dhe distinktiv.

(2)Inspektori, gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese, është i obliguar ta tregojë legjitimacionin zyrtar dhe distinktivin, e me kërkesë të subjektit të mbikëqyrjes inspektuese, t'i lejojë ta shohë.

Neni 19

Në rast të pushimit të marrëdhënies së punës ose suspendimit në pajtim me Ligjin, inspektori është i detyruar me ditën e miratimit të aktvendimit për pushim të marrëdhënies së punës, përkatësisht aktvendimit për suspendim, t'ia kthejë legjitimacionin zyrtar dhe distinktivin drejtorit që ia ka lëshuar.

Neni 20

(1) Mbikëqyrja inspektuese mund të jetë e rregullt, e jashtëzakonshme dhe kontrolluese.

(2) Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese në pajtim me këtë ligj, në mënyrë përkatëse do të zbatohen dispozitat e Ligjit për mbikëqyrje inspektuese.

Neni 21

Subjekti i mbikëqyrjes inspektuese është i obliguar të bashkëpunojë dhe me kërkesë të inspektorit t'i mundësojë qasje të papenguar në hapësirat, dokumentet, sistemet elektronike, mjetet për komunikim ose transport ose cilido mjet tjetër, objekt të mbikëqyrjes inspektuese, si dhe ta dorëzojë dokumentacionin e plotë të nevojshëm për kryerje të mbikëqyrjes inspektuese.

Neni 22

(1) Për mbikëqyrjen e kryer inspektuese, gjendjen e konstatuar faktike, parregullsitë dhe mangësitë e konstatuara, vërejtjet, deklaratat dhe faktet dhe rrethanat tjera relevante, inspektori përpilon procesverbal me shkrim në vendin e kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese.

(2) Procesverbalin nga paragrafi (1) i këtij neni, e nënshkruajnë inspektori dhe subjekti i mbikëqyrjes inspektuese të cilit i dorëzohet një ekzemplar. Nëse subjekti i mbikëqyrjes inspektuese refuzon ta nënshkruajë procesverbalin, inspektori do t'i shënojë shkaqet e refuzimit.

(3) Me përjashtim të paragrafit (1) të këtij neni, kur për shkak të vëllimit dhe ndërlikueshmërisë së mbikëqyrjes inspektuese, natyrës dhe rrethanave të tij të punës, nuk ka mundësi të përpilojë procesverbal në vendin e kryerjes së mbikëqyrjes, procesverbali përpilohet në hapësirat zyrtare të Inspektoratit në afat prej tri ditësh nga dita e mbikëqyrjes inspektuese me arsyetim për shkaqet për këtë.

(4) Ekzemplar i procesverbalit nga paragrafi (3) i këtij neni i dorëzohet për nënshkrim subjektit të mbikëqyrjes inspektuese. Nëse në afat prej tetë ditësh nga dita e pranimit, subjekti i mbikëqyrjes inspektuese nuk prononcohet në lidhje me procesverbalin e dorëzuar ose nuk e kthen të nënshkruar, konsiderohet se është pajtuar me përmbajtjen e tij.

Neni 23

(1) Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese, inspektori me aktvendim shqipton vërejtje dhe cakton afat në të cilin subjekti i mbikëqyrjes inspektuese është i obliguar t'i mënjanojë parregullsitë dhe mangësitë, të përcaktuara me procesverbal.

(2) Nëse pas skadimit të afatit të caktuar gjatë shqiptimit të vërejtjes nga paragrafi (1) i këtij neni, inspektori konstaton se parregullsitë dhe mangësitë ende nuk janë mënjanuar, me aktvendim shqipton masë tjetër inspektuese, nëse është përcaktuar me ligj të veçantë, me të cilën do të arrihet në mënyrë më adekuate qëllimi i mbikëqyrjes inspektuese.

(3) Aktvendimi nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, miratohet menjëherë, e më së voni në afat prej tetë ditësh nga dita e përgatitjes së procesverbalit nga neni 19 i këtij ligji, përkatësisht shqiptimi i vërejtjes.

(4) Kur gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese nuk janë konstatuar parregullsi dhe shkelje tjera të Ligjit ose rregullativës tjetër, apo parregullsitë e përcaktuara janë mënjanuar gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese ose në afatin e përcaktuar me aktvendimin nga paragrafi (1) i këtij neni, inspektori e ndërpret procedurën me konstatim në procesverbalin nga neni 19 i këtij ligji.

(5) Me përjashtim nga paragrafi (2) i këtij neni, inspektori mund të shqiptojë masë inspektuese me aktvendim me gojë të shënuar në procesverbalin nga neni 19 i këtij ligji.

(6) Në rastin nga paragrafi (5) i këtij neni, inspektori është i detyruar që menjëherë, e më së voni në afatin e përcaktuar në paragrafin (3) të këtij neni, të miratojë aktvendim me shkrim për shqiptim të masës inspektuese.

Neni 24

Kundër aktvendimit të inspektorit nga neni 20 paragrafët 1 dhe 2 të këtij ligji, mund të parashtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktvendimit në Komisionin Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë.

Neni 25

Nëse inspektori konstaton se ekziston bazë për ndërmarrjen e masave administrative dhe masave tjera, për të cilën është kompetent një organ tjetër, është i detyruar që më së voni në afat prej tri ditësh ta njoftojë atë organ.

Neni 26

(1) Personat juridikë dhe fizikë, shoqatat dhe qytetarët mund të parashtrojnë iniciativë te Inspektorati në lidhje me shkeljen e rregullave me kompetencë të Inspektoratit.

(2) Inspektorati në pajtim me iniciativat e parashtruara nga paragrafi 1 i këtij neni vepron në pajtim me Ligjin për mbikëqyrje inspektuese.

V. DISPOZITA KUNDËRVAJTËSE

Neni 27

(1) Gjobë në shumë prej 300 deri në 500 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik nëse nuk vepron në pajtim me nenin 21 të këtij ligji.

(2) Gjobë në shumë prej 100 deri në 200 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit përgjegjës të personit juridik për kundërvajtjen nga paragrafi 1 i këtij neni.

(3) Për kundërvajtjet e përcaktuara me këtë ligj, procedurë për kundërvajtje mban dhe sanksion për kundërvajtje shqipton gjykata kompetente.

VI. DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDITMARE

Neni 28

Drejtorin e Inspektoratit do ta emërojë Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut në afat prej tre muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 29

Inspektorati do të fillojë me punë nga dita e emërimit të drejtorit të Inspektoratit.

Neni 30

Aktet për organizimin e brendshëm dhe sistematizim të vendeve të punës drejtori do t'i miratojë më së voni 15 ditë nga dita e emërimit të tij.

Neni 31

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e publikimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut", ndërsa do të fillojë të zbatohet nga 15 janari 2020.


РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
СОБРАНИЕ
НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
KUVENDI
I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT
REPUBLIC OF NORTH MACEDONIA
ASSEMBLY
OF THE REPUBLIC OF NORTH MACEDONIA


Република Северна Македонија
ПРЕТСЕДАТЕЛ
Republika e Maqedonisë së Veriut
PRESIDENTI
Republic of North Macedonia
PRESIDENT


ВЛАДА
НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
QEVERIA
E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT
GOVERNMENT
OF THE REPUBLIC OF NORTH MACEDONIA

E drejta autoriale është e drejtë ekskluzive e
Agjencisë për Zbatimin e Gjuhës

Adresa:
shëtitorja “Dimitar Vllahov” Nr. 4, kati i IV-të,
1000, Shkup

Tel: +389 72 916 708
e-mail: info@apj.gov.mk;
web: www.apj.gov.mk

